



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 552/3 prot.

Tiranë më 16.04.2018

REKOMANDIM

Nr. 16, datë 16.04.2018

PËR KONTROLLUESIN "WHITE DREAM HOTEL"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "White Dream Hotel",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.110 datë 23.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "White Dream Hotel", me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "White Dream Hotel".

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelerisë, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe klientë".

Kontrolluesi "White Dream Hotel", është subjekt juridik me NIPT: K324090160 dhe objekt aktiviteti "Aktivitet në fushën e hotelerisë, restorante, bare bufe etj...."

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim në datë 05.04.2018, u konstatua se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit. Më datë 31.03.2018 sikurse rezulton nga verifikimi në regjistrin elektronik të njoftimeve, kontrolluesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit "Formularin e Njoftimit";

2. Kontrolluesi ka hartuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale megjithatë konstatohet se ajo ka nevojë të përshtatet në varësi të aktivitetit, qëllimit të përpunimit të të dhënave, përcaktimit të kategorive të të dhënave që përpunohen etj;
3. Kontrolluesi ka nënshkruar *"Deklaratë Konfidencialiteti"* me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale;
4. Ambientet e brendshme të hotelit janë të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit CCTV. Konstatohet që në hyrjen e hotelit janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të Video-Vëzhgimit CCTV. Koha e ruajtjes së të dhënave në sistem është që nga data 01.12.2017, përtej afatit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit. Kontrolluesi ka vendosur kamera në ambiente të tilla si pishinë (e cila mbikëqyr vetëm strukturën e pishinës) si dhe në ambientet e palestrës;
5. Kontrolluesi nuk ka hartuar dhe publikuar *"Politikat e Privatësisë"* në portalin zyrtar të <http://www.whitedreamhotel.com>. Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manual dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit online në internet, ka detyrim që të publikojë *"Politikat e Privatësisë"* pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit.

Pas konstatimeve të mësipërme rezulton se:

1. Lidhur me pikën e parë të konstatimit, (depozitimin e *"Formularit të Aplikimit"* për realizimin e *"Njoftimit"* pranë Zyrës së Komisionerit), në nenin 21 *"Përgjegjësia për të njoftuar"* në pikën 1, të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar thuhet: *"Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"*. Fakti që kontrolluesi ka depozituar formularin e njoftimit më datë 31.03.2018, mbas marrjes dijeni nëpërmjet urdhrin për kryerjen e hetimit administrativ përbën shkelje administrative të nenit 21 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*.
2. Lidhur me pikën e dytë të konstatimit, (hartimin e një rregulloreje për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale) në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, në pikën 2/1 përcaktohet se: *"Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera"*. Kontrolluesi ka hartuar rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale duke u bazuar në modelin standard të postuar në faqen e Komisionerit, por kontrolluesi nuk e ka përshtatur këtë rregullore sipas specifikave të aktivitetit që

kryen dhe ky fakt përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

3. Lidhur me pikën e katërt të konstatimit, ruajtja e imazheve dhe videove në sistemin e vëzhgimit CCTV përtej afateve të përcaktuara nga ligji vlen për tu përmendur fakti se, legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale përcakton se imazhet nuk mund të ruhen përtej afatit 60 ditor. Gjatë kontrollit të bërë në serverat e kontrolluesit u konstatua se të dhënat e sistemit të video vëzhgimit ruheshin prej datës 01.12.2017 në shkelje të neneve 5 dhe 6 të Ligjit si dhe udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*.
4. Lidhur me pikën e pestë të konstatimit, mungesa e hartimit dhe publikimit të politikave të privatësisë në portalin zyrtar të <http://www.whitedreamhotel.com> jashtë standardeve të kërkuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave, përbëjnë shkelje të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

Faktet e mësipërme, përbëjnë shkelje të dispozitave, 18, 21 dhe 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* por nisur nga fakti që kontrolluesi u tregua bashkëpunues me grupin e kontrollit si dhe tregoi gatishmëri për përmbushjen e menjëhershme të konstatimeve, Zyra e Komisionerit vlerëson se dalja me akt rekomandues plotëson më së miri përfundimin e këtij kontrolli.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, kontrolluesi *“White Dream Hotel”*, të hartojë rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në përputhje me veprimtarinë e tij.
2. Në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, kontrolluesi *“White Dream Hotel”*, të shkatërrojë imazhet dhe videot në sistemin e vëzhgimit CCTV që janë në tejkalim të kufirit maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video survejimit dhe në vazhdimësi të ruaj këto të dhëna vetëm brenda afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 3/2010 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*.

3. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "White Dream Hotel" të hartojë dhe publikojë politikat e privatësisë në portalin zyrtar.
4. Kontrolluesi "White Dream Hotel", të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijani. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi "White Dream Hotel", përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 16.04.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

